# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7832
E enjte, 11 korrik 2024
Çmimi 0. 50


## 1 000 euro bursë vjetore për ata që studiojnë Gjuhë Shqipe dhe Letërsi Shqipe

FAQE 3





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# NATO-ja: PREMTIME TË REJA PËR UKRAINËN DHE NJË BIDEN LUFTARAK

FAQE 3



Në samitin e NATO-s, ShBA-ja dhe partnerët e saj i premtuan Ukrainës ndihmë të mëtejshme, megjithëse nuk i përmbushi disa pritshmëri. Si u paraqit Bideni?

## QEVERIA E KOSOVËS SHPALL 11 KORRIKUN DITË PËRKUJTIMORE TË GJENOCIDIT NË SREBRENICË

F. 3



## OSMANI TAKON BLINKENIN: ALEANCA ME SHBA-në, GURTHEMEL PËR STABILITETIN DHE PROSPERITETIN GLOBAL

F. 5



## AKTUALE



### NORVEGJIA DO T'IA DHUROJË UKRAINËS GJASHTË AVIONË LUFTARAKË F-16

F. 2

### HARADINAJ TAKON JASHARAJN, I PREMTON RRITJE 50 % TË PAGAVE PËR PUNËTORËT E ARSIMIT

F. 7

### VEPRIMTARI BISLIMI TAKOHET ME SHEFIN E SHËNDETËSISË DHE TË TRANSPORTIT TË GJENEVËS, BISEDOJNË PËR RAPORTET KOSOVË - ZVICËR

F. 6

## EKONOMI



### "PËR BUKËN E MOTMOTIT", KURTI NGA MALISHEVA: PRODHIMTARIA E GRURIT NË KOSOVË DO T'I TEJKALOJË NEVOJAT PËR IMPORT

F. 8

### ATK-ja VERIFIKON MALLRAT PA ORIGJINË

F. 8

## SPORT



### ANGLIA FITON NDAJ HOLANDËS, I BASHKOHET NË FINALE SPANJËS

F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Norvegjia do t'ia dhurojë Ukrainës gjashtë avionë luftarakë F-16



**Oslo, 10 korrik** - Norvegjia do t'ia dhurojë Ukrainës gjashtë avionë luftarakë F-16 për ta ndihmuar të mbrohet kundër sulmeve ajrore ruse, tha qeveria norvegjeze në një komunikatë të mërkurën. Ky njoftim vjen në ditën kur liderët e vendeve anëtare të NATO-s po marrin pjesë në një samit në Uashington. Ata pritet të njoftojnë për ndihmën e re që do t'ia japin Ukrainës në luftën e saj kundër pushtimit nga Rusia, i cili nisi në shkurt 2022.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, dëshiron që vendet anëtare t'i dërgojnë Kievit më shumë armë dhe para, si dhe t'i ofrojnë garanci të sigurisë, me shpresë se kjo do ta ndryshojë rrjedhën e luftës.

Kryeministri norvegjez Jonas Gahr Stoere tha se dërgimi i avionëve F-16 do të fillojë këtë vit. "Të kombinuar me sisteme mbrojtëse ajrore, avionët luftarakë do të jenë jetikë për t'ia mundësuar Ukrainës të mbrohet kundër sulmeve ajrore ruse", tha Stoere në një komunikatë. Kryeministri për herë të parë njoftoi në gusht të vitit të kaluar se Norvegjia do t'i dërgonte Kievit avionë F-16, por nuk tregoi sasinë asokohe. Prej atëherë, Oslo i ka dërguar dy avionë F-16 në Danimarkë që të përdoren për trajnimin e pilotëve ukrainas.

Ukraina ka kohë të gjatë që dëshiron t'i ketë në dorë avionët luftarakë F-16 për shkak të fuqisë së tyre shkatërruese.

Ndërkohë, Danimarka është zotuar se do t'i dhurojë 19 avionë luftarakë në përgjithësi Ukrainës, ndërsa Holanda ia ka premtuar 24 sosh. Këto dy vende kanë qenë forcë shtytëse e koalicionit ndërkombëtar për furnizimin e Ukrainës me avionët F-16.

Forca Ajrore e Norvegjisë i zëvendësoi avionët e vet F-16 me modelin pasardhës F-35.

# Zelensky thotë se Ukrainës i duhen më shumë avionë F-16



**Kiev, 10 korrik** - Ukraina ka nevojë për më shumë se 120 avionë luftarakë F-16 për ta arritur barazinë me Rusinë në qiell, tha presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky. "Rusia përdor 300 avionë luftarakë kundër Ukrainës çdo ditë. Është vendosur që ne të marrim rreth 10 deri në 20. Edhe nëse do të ishin 50, nuk do të ishin asgjë. Për t'u mbrojtur [me efikasitet] na duhen 128 F-16", tha Zelensky gjatë një fjalimi në Institutin Ronald Reagan në Uashington.

Vendet e NATO-s janë zotuar se do t'i sigurojnë rreth 65 avionë F-16 Ukrainës për të luftuar kundër pushtimit rus. Pilotët ukrainas tashmë janë duke u trajnuar për përdorimin e tyre në Shtetet e Bashkuara, Holandë dhe Rumani.

Gazeta "New York Times" ka raportuar më herët se Ukraina do të mund të marrë vetëm gjashtë avionë F-16 deri në korrik, ndërsa gjatës verës do të jenë gati 12 pilotë.

Autoritetet e Ukrainës kanë deklaruar vazhdimisht se avionët luftarakë perëndimorë mund ta ndryshojnë situatën në fushëbetejë, sepse Rusia ka "epërsi të plotë në qiell" në territoret e pushtuara.

Duke folur në hapje të Samitit të NATO-s më 9 korrik, presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, është zotuar se do t'i sigurojë Ukrainës sisteme të reja të mbrojtjes ajrore.

# Në PE nis iniciativa për t'i pezulluar Hungarisë të drejtën e votës

**Bruksel, 10 korrik** - Në Parlamentin Evropian nisi një iniciativë për t'iu kërkuar organeve përgjegjëse të Bashkimit Evropian që t'ia pezullojnë Hungarisë të drejtën e votës për shkak të veprimeve të fundit të kryeministrit të këtij vendi, Viktor Orban.

Riho Terras, përfaqësues në PE nga grupi më i madh politik, Partia Popullore Evropiane, u dërgoi një letër të gjithë deputetëve evropianë, duke kërkuar mbështetjen e tyre.

Të njëjtën do t'ia dërgojë edhe presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, presidentit të Këshillit Evropian, Charles Michel, dhe presidentes së Parlamentit Evropian, Roberta Metsola. "Presidenca hungareze sapo ka filluar dhe kryeministri Orban ka shkaktuar tashmë dëme të konsiderueshme, duke abuzuar me rolin e Presidencës së Këshillit. Në misionin e tij të ashtuquajtur paqeruajtës, ai qëllimisht ka krijuar përshtypjen se vepron në emër të të gjithë Bashkimit Evropian, ndërkohë që, në realitet, ai nuk ka asnjë autoritet ta përfaqësojë BE-në apo ndonjë shtet tjetër anëtar të BE-së, përveç të vetit", thuhet në letrën që pa Radio Evropa e Lirë.

Shkak për këtë letër u bënë vizitat e Orbanit në Ukrainë, Rusi dhe Kinë në ditët e para të këtij muaji. Orban u takua edhe me presidentin rus Vladimir Putin në Moskë, veprim ky që u dënua nga të gjithë aktorët kryesorë të BE-së.

Hungaria mori presidencën gjashtëmujore të Bashkimit Evropian nga 1 korriku.

Sipas letrës së deputetëve evropianë, Orban po përpiqet t'i minojë vendimet ekzistuese të BE-së, procesin e vendimmarrjes dhe unitetin e BE-së për çështje të rëndësishme. "Kjo nuk mund të lejohet të vazhdojë. Duhen hapa vendimtarë për t'i kufizuar dëmet e mëtejshme", thuhet në letër.



Procedurat dhe pezullimet e të drejtave të votës janë komplekse. Për to janë përgjegjëse shtetet anëtare.

Neni 7 i Marrëveshjes për Bashkimin Evropian, në të cilin thirret letra, e lejon mundësinë e pezullimit të së drejtës së anëtarësimit në Bashkimin Evropian (siç është e drejta për të votuar në Këshillin e Bashkimit Evropian), nëse një vend shkel seriozisht dhe në mënyrë të vazhdueshme parimet mbi të cilat bazohet BE-ja.

Elementet që do ta nxisnin zbatimin e këtij neni përfshijnë: respektimin e dinjitetit njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave themelore, përfshirë të drejtat e pjesëtarëve të pakicave.

Për ta vënë në zbatim nenin 7, me propozimin e një të tretës së shteteve anëtare të BE-së, ose Parlamentit Evropian, ose Komisionit Evropian, Këshilli - duke vepruar me një shumicë prej katër të pestave të anëtarëve të tij, pas marrjes së pëlqimit nga Parlamenti - mund të përcaktojë se ekziston rrezik i qartë i shkeljes së rëndë të këtyre parimeve bazë nga shteti anëtar dhe t'i nxjerrë rekomandimet e duhura.

Neni 354 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon procedurat e votimit që duhet të ndiqen nga institucionet kryesore të BE-së, kur një shtet anëtar përballet me zbatimin e nenit 7.

Vendi në fjalë nuk merr pjesë në votim. Ai nuk përfshihet në llogaritjen e një të tretës së vendeve që kërkohen për propozimin, ose në të katër të pestat që kërkohen për një shumicë.

Për pëlqimin e Parlamentit kërkohet një shumicë prej dy të tretash.

Përfaqësuesit evropianë kanë afat deri më 12 korrik për ta nënshkruar këtë letër, e cila më pas do t'u përcillet udhëheqësve të institucioneve evropiane.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

## KQZ-ja regjistron një parti politike dhe pezullon një tjetër



**Prishtinë, 10 korrik** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me 10 vota për ka votuar për ta pezulluar subjektin politik “Graoanska Inicijativa Gore” për shkak se ky subjekt politik nuk ka mbajtur Kuvendin Zgjedhor me datën e paraparë, më 20 qershor të këtij viti.

Drejtor i Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Partive Politike, Besnik Buzhala, ishte ai që dha këtë rekomandim, duke thënë se Kuvendi është dashur të mbahej më 20 qershor. “Kuvendi i radhës për t’u mbajtur nga ky subjekt politik, data e fundit ka qenë 20 qershor 2024. Meqenëse subjekti politik nuk e ka mbajtur Kuvendin Zgjedhor më 20 qershor 2024, atëherë zyra rekomandon të pezullohet subjekti politik Graoanska Inicijativa Gore, me akronimin GIG dhe KZQ-ja të marrë vendim dhe ta obligojë që për 45 ditë prej momentit të pranimit të këtij vendimi, të mbajë Kuvendin Zgjedhor të radhës. Ky është rekomandimi sa i përket vendimit për pezullimin e subjektit politik Graoanska Inicijativa Gore”, ka thënë Besnik Buzhala.

Ndërsa kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, tregoi që ky rekomandim u votua më 10 vota për, çka bëri që kjo parti politike të pezullohet.

Në mbledhjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, drejtori Besnik Buzhala rekomandoi regjistrimin e partisë politike “Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës”. Besnik Buzhala potencoi se ky subjekt politik është subjekt parlamentar i cili, gjithashtu, përfiton edhe mjete financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike.

## Qeveria e Kosovës shpall 11 Korrikun Ditë Përkujtimore të Gjenocidit në Srebrenicë

**Prishtinë, 10 korrik** - Qeveria e Kosovës e ka shpallur 11 Korrikun Ditë Përkujtimore të Gjenocidit në Srebrenicë të Bosnjë-Hercegovinës, bazuar në rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të 23 majit.



Duke folur në mbledhjen e qeverisë mbajtur të mërkurën, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se ky është “një veprim fisnik dhe i duhur në emër të Kosovës”.

“Është veprim i universales sonë njerëzore dhe i dëshirës sonë për paqe, që të mos harrohet e të mos përsëritet më gjenocidi as në Bosnjë, as në Kosovë dhe askund tjetër në rajonin tonë dhe në botë”, tha Kurti.

Më 2021 Kuvendi i Kosovës e miratoi një rezolutë për dënimin e gjenocidit në Srebrenicë të Bosnjë-Hercegovinës. Në maj të këtij viti, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e shpalli 11 Korrikun Ditë Ndërkombëtare të Përkujtimit të Gjenocidit në Srebrenicë.

Në Srebrenicë dhe zonat përreth, forcat serbe të Bosnjës vranë më shumë se 8 300 boshnjakë në korrik të vitit 1995. “Le të jetë kjo ditë një kujtesë e përhershme e vuajtjes dhe pikëllimit tonë të përbashkët, forcës sonë për të ndërtuar një të ardhme më të ndritur dhe përkushtimit tonë për ruajtjen e së vërtetës, paqes, drejtësisë dhe të drejtave të njeriut”, tha zëvendëskryeministrja e Kosovës, Emilija Rexhepi, e cila vjen nga komuniteti boshnjak.

Nenad Rashiq, ministër për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës nga komuniteti serb, i cili e mbështeti këtë vendim, tha se është e rëndësishme të thuhet se “kriminelët dhe gjenocidi kanë emrat dhe mbiemrat e tyre dhe nuk duhet të përgjithësohen për një popull të caktuar, ose një vend të caktuar, por mbi autorët individualë që e bënë këtë, duke mos menduar as për viktimat dhe as për njerëzit e tyre”.

Më 2007 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë lëshoi një vendim që thotë se Ushtria e Republikës Sërpska kreu gjenocid në Srebrenicë në korrik të vitit 1995. Atëbotë Srebrenica ishte zonë e mbrojtur e OKB-së.

Gjykata e njëjtë gjeti se Serbinë fajtore për mosparandalimin e gjenocidit. Gjykata, po ashtu, tha se Serbia ka shkelur obligimin për t’i ndëshkuar kryesit e gjenocidit. Para këtij vendimi, disa gjykata kanë dënuar më shumë se 50 persona me mbi 700 vjet burgim për gjenocid dhe krime lufte në Srebrenicë. Në mesin e tyre janë edhe ish-presidenti i Republikës Sërpska, Radovan Karaxhiq, dhe komandanti i përgjithshëm i ushtrisë së atëhershme serbe, Ratko Mlladiq. Të dy janë dënuar me burim të përjetshëm.

## Nënshkruhet rregullorja për planifikimin, programimin, buxhetimin dhe ekzekutimin në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK



**Prishtinë, 10 korrik** - Ministria e Mbrojtjes ka shënuar një hap të rëndësishëm në aspektin e zhvillimit afatgjatë të Strategjisë së Menaxhimit të Sistemit të Mbrojtjes përmes Rregullores së nënshkruar për përcaktimin e procesit të Planifikimit, Programimit, Buxhetimit dhe Ekzekutimit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Kështu ka bërë me dije ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci.

Ai ka thënë se ky dokument thelbësor për zhvillimin e kapaciteteve institucionale të mbrojtjes në një periudhë afatgjatë, është hartuar pas një analize të detajuar ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, mbështetur nga Ambasada e ShBA-së përmes angazhimit të këshilltarit për PPBE, Joe Duncan, në kuadër të Programit Global të Reformës së Mbrojtjes. “Rregullorja përveçse qartëson secilin hap nga planifikimi deri në ekzekutim të aktiviteteteve që mbështesin në mënyrë direkte zbatimin e Planit të Përgjithshëm të Tranzicionit, përcakton dhe përgjegjësitë, autoritetin vendimmarrës, mënyrën e menaxhimit dhe koordinimin e monitorimin në MM dhe FSK. Përmes zbatimit të rregullores, procesi ciklik i PPBE-së do të jetë më efektiv e efikas në menaxhimin, shpërndarjen dhe përdorimin e burimeve të mbrojtjes që do të zbatohet në mënyrë rutinore, me qëllim të rritjes së aftësive në përmbushje të misionit kushtetues dhe ligjor të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, si aleat i vyer në të ardhmen i NATO-s”, ka theksuar Maqedonci.

## 1 000 euro bursë vjetore për ata që studiojnë Gjuhë Shqipe dhe Letërsi Shqipe

**Prishtinë, 10 korrik** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka njoftuar se për studentët që zgjedhin të studiojnë në programin Gjuhë Shqipe ose në programin Letërsi Shqipe të Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, do të jepen 1 000 euro bursë vjetore.

“Konkursi për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve tashmë është i hapur. Ju ftojmë që të aplikoni në këto programe dhe të përfitoni bursën studentore”, ka shkruar Kurti.

Edhe Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP) njofton se përmes marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MAShTI) do ta realizojë mbështetjen e qëndrueshme dhe të vazhdueshme për promovimin dhe zhvillimin e shkencave të albanistikës. “Përmes këtij bashkëpunimi mundësohet dhënia e bursave vjetore për studentët që regjistrohen në programin BA Gjuhë Shqipe dhe programin Letërsi Shqipe në Fakultetin e Filologjisë të UP-së. Bursa studentore individuale është në vlerë prej 1 000 (një mijë) eurosh në vit për student. Eja dhe regjistrohu në UP!”, thuhet në njoftim.






# NATO-ja: Premtime të reja për Ukrainën dhe një Biden luftarak

Në samitin e NATO-s, ShBA-ja dhe partnerët e saj i premtuan Ukrainës ndihmë të mëtejshme, megjithëse nuk i përmbushi disa pritshmëri. Si u paraqit Bideni?

UASHINGTON, 10 KORRIK - Në fillim të takimit të presidentëve të shteteve dhe qeverive anëtare të NATO-s në Uashington, presidenti amerikan Joe Biden njoftoi se së bashku me partnerët e tij do t'i vë në dispozicion Ukrainës armë shtesë për mbrojtje. Së bashku me Gjermaninë, Rumaninë, Holandën dhe Italinë, "do të dorëzohen sisteme shtesë strategjike për mbrojtje ajrore, duke përfshirë sisteme shtesë Patriot, të cilat do të dhurohen nga Shtetet e Bashkuara, Gjermania dhe Rumania".

Në fjalimin e tij në ceremoninë e shënimit të 75-vjetorit të themelimit të NATO-s, Bideni tha se gjatë vitit të ardhshëm Ukraina do të marrë edhe qindra raketa shtesë mbrojtëse të nevojshme për të mbrojtur qytetet ukrainase nga sulmet raketore ruse. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenski ka përsëritur muajt e fundit se sistemet shtesë Patriot janë absolutisht të nevojshme për të mbrojtur qytetet e Ukrainës dhe zonat me popullsi të dendur. "Mesazhi ynë për Moskën dhe botën është i qartë: mbështetja jonë për Ukrainën është e fortë dhe e qëndrueshme", thuhet në një deklaratë të përbashkët të presidentit amerikan Biden, kancelarit gjerman Olaf Scholz dhe krerëve të shteteve apo qeverive të Rumanisë, Holandës dhe Italisë.

## Sistemet Patriot për Ukrainën

Megjithëse Bideni e quajti ndihmën e premtuar historike, shumica e saj nuk është e re dhe nga pikëpamja ukrainase nuk është ajo që dëshironte presidenti Zelenski. Sipas burimeve qeveritare, kontributi gjerman është një nga tre sistemet antiraketë Patriot që tashmë janë dorëzuar. Rumania dhe Holanda gjithashtu kanë njoftuar më parë ndihmën e tyre.

Shtetet e Bashkuara po dërgojnë një sistem shtesë Patriot, pasi e kanë dorëzuar tashmë një më parë. Sistemi i mbrojtjes kundër raketave Patriot është ndër më modernët në botë. Ai shërben për mbrojtje nga avionët, raketat balistike dhe raketat me rreze të gjata. Nga qarqet e NATO-s u dëgjua se shumëkush është i zhgënjyer për faktin se nuk ishte e mundur të arrihej një marrëveshje për dërgimin e më shumë sistemeve Patriot deri në këtë samit të NATO-s.

## Zelenski falënderoi aleatët

Lufta në Ukrainë është një nga temat kryesore në samitin e NATO-s në Uashington. Presidentët e shteteve dhe krerët e qeverive të 32 shteteve anëtare të Aleancës po festojnë 75 vjetorin e themelimit të NATO-s. Zelenski falënderoi ShBA-në, Gjermaninë dhe anëtarët e tjerë të Aleancës për forcimin e planifikuar të mbrojtjes kundërajrore të vendit të tij. Ai është mirënjohës ndaj partnerëve që pranuan deklaratën e mbështetjes për mbrojtjen ajrore të Ukrainës, shkroi Zelenski në platformën X. Sistemet shtesë të mbrojtjes ajrore do të ndihmojnë në shkatërrimin e dronëve dhe raketave ruse dhe do të mbrojnë më mirë ukrainasit nga terrori ajror rus, shkroi Zelenski.

Ky është një hap i rëndësishëm pas vendimit të ShBA-së për t'i dhënë Ukrainës përparësi në dërgimin e raketave kundërajrore, shkroi më tej Zelenski, duke shtuar se ai është mirënjohës ndaj presidentit Biden për rolin e tij udhëheqës dhe të gjitha vendeve partnere për angazhimin e tyre.

## Performancë e mirë nga Bideni

Vëmendja e vëzhguesve u përqendrua në performancën e presidentit amerikan Biden, ndoshta më shumë sesa në njoftimin për ndihmë shtesë për Ukrainën. Pas performancës katastrofike të Bidenit në përballjen televizive me sfiduesin republikan Donald Trump, në ShBA është zhvilluar një diskutim i madh, nëse Biden mund të mbetet kandidati presidencial demokrat. Tani për tani, çdo lëvizje e Biden po vëzhgohet nga afër.

Prandaj, në fjalimin e tij, ai u përpoq dukshëm të largonte çdo dyshim në lidhje me aftësinë e tij për të kryer detyrat presidenciale: ai nuk bëri asnjë gabim në tekst, nuk e humbi mendjen dhe përqendrimin. Biden e prezantoi veten si një luftëtar - dhe para audiencës së tij si lider i gjithë botës së lirë.

Por ai kishte edhe një asistencë teknike me teleprompter, që përdoret zakonisht në televizion, por që është e zakonshme edhe për ngjarje të tilla.

## Çfarë mund të bëjë sistemi Patriot?

Sistemi i mbrojtjes ajrore Patriot përbëhet nga raketa me drejtim automatik dhe funksionon me ndihmën e radarit. Si rregull, instalimi i radarit dhe kontejneri i lëshimit janë montuar në një kamion në mënyrë që të jenë të lëvizshëm. Sistemi aktualisht konsiderohet si një nga sistemet më moderne të mbrojtjes ajrore. Ky sistem u zhvillua në vitet 1960 në ShBA dhe disa kompani gjermane morën pjesë në zhvillimin e saj. Mund të përdoret për mbrojtje kundër avionëve, raketave me rreze të gjata dhe raketave balistike, por nuk është i përshtatshëm për mbrojtje kundër predhave më të vogla.

Sistemi Patriot mund të shkatërrojë në të njëjtën kohë deri në pesë objektiva të ndryshëm. Gjermania e ka këtë sistem që nga viti 1989. Sipas prodhuesit, sistemin Patriot e kanë 12 vende, gjashtë prej të cilave janë pjesë e NATO-s. (DW)

# Osmani takon Blinkenin: Aleanca me ShBA-në, gurthemel për stabilitetin dhe prosperitetin global

Prishtinë, 10 korrik - Presidentja Vjosa Osmani, në kuadër të Samitit të NATO-s, ka takuar sekretarin amerikan Antony Blinken. Ajo ka thënë se aleanca me ShBA-në nuk është vetëm një dëshmi e vlerave dhe parimeve tona të përbashkëta demokratike, por një gurthemel për stabilitetin dhe prosperitetin global.
Osmani ka takuar edhe ndihmëssekretarin e Shtetit, Jim O'Brien. Ajo ka treguar se me të ka pasur diskutim përmbajtjesor mbi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë me aleatët tanë amerikanë për tejkalimin e sfidave të përbashkëta si dhe për mbrojtjen e lirisë, pavarësisë dhe demokracisë sonë. "Bashkë diskutuam edhe për zhvillimet e fundit në dialogun me Serbinë dhe rëndësinë e rolit të ShBA-së për suksesin e këtij procesi", ka thënë Osmani.
Aspiratat e Kosovës për anëtarësim në NATO ishin temë e takimit mes presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, dhe kryeministrit të Bullgarisë, Dimitar Glavchev. Dy udhëheqësit u takuan të martën në Uashington, në margjina të Samitit të NATO-s.
Osmani tha se Bullgaria është mbështetëse e palëkundur e Kosovës, në përpjekjet e saj për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, thuhet në komunikatën e lëshuar nga Zyra e Presidentes.
Në një postim në "Facebook", Glavchev tha se Osmani kërkoi mbështetje dhe ndihmë për anëtarësimin e Kosovës në aleancë dhe se ajo mori garanci prej tij se Bullgaria do të votojë "me të dyja duart" për Kosovën, kur ajo t'i plotësojë kushtet për anëtarësim.
Autoritetet në Kosovë kanë kërkuar anëtarësim të përshpejtuar në NATO pas shpërthimit të luftës në Ukrainë në shkurt të vitit 2022. Por, marrë parasysh se në radhët e saj janë katër shtete që nuk e njohin Kosovën - Greqia, Spanja, Rumania dhe Sllovakia - dhe vendimi për zgjerimin duhet të merret në mënyrë unanime, ajo kërkesë nuk ka shkuar përpara.
Osmani ndodhet në Uashington me ftesë të sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken. Ajo mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, i cili u mbajt në kuadër të Samitit të NATO-s. Samiti, që përkon me 75-vjetorin e themelimit të aleancës ushtarake, nisi më 9 korrik dhe do të mbyllet më 11 korrik.



# Senatorët amerikanë rikonfirmojnë përkushtimin e ShBA-së për Ballkanin Perëndimor

Uashington, 10 korrik - Bashkëkryetarët e Grupit Vëzhgues të NATO-s në Senatin amerikan, demokratja Jean Shaheen dhe republikani Thom Tillis, shprehën përkushtimin e tyre ndaj paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor dhe diskutuan për mënyrat se si Shtetet e Bashkuara mund t'i mbështesin aspiratat e vendeve të rajonit për anëtarësim në Bashkimin Evropian.
Dy senatorët i shprehën qëndrimet e tyre në një njoftim për medie, pas një takimi që zhvilluan në Uashington me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Hristijan Mickoski, dhe ministrin e Jashtëm të Malit të Zi, Fillip Ivanoviq, të cilët gjenden atje për Samitin e NATO-s.



Senatorët vlerësuan kontributet e këtyre vendeve në NATO, mbështetjen e vazhdueshme të tyre për Ukrainën dhe rolin e tyre ndaj stabilitetit rajonal. "Ne kemi mundësi ta demonstrojmë përkushtimin tonë ndaj Ballkanit Perëndimor, duke mbështetur përparimin e secilit nga këto vende drejt anëtarësimit në BE - gjë që do të ndihmonte që aleanca jonë transatlantike të arrinte stabilitet rajonal dhe global", tha senatorja Shaheen. "Rajoni i Ballkanit Perëndimor është kritik për sigurinë e Evropës dhe, si bashkëkryetarë të Grupit Vëzhgues të NATO-s në Senat, ne e bëmë të qartë se Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara për t'iu kundërvënë regjimeve totalitare", tha senatori Tillis.
Në takim morën pjesë edhe senatorët republikanë Mike Rounds, Jerry Moran dhe Pete Ricketts, raporton Zëri i Amerikës.

## Marrëveshje bashkëpunimi për rinovimin e objektit të ish-furrës në Podujevë

Podujevë, 10 korrik - Kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me pronarin e Kompanisë "Berisha Group", Naim Berisha, për rinovimin e objektit të ish-furrës në Rrugën "Ali Ajeti" në qytet.
Përfundimisht furra ishte mbyllur në vitin 2018 dhe për shkak të mosfunksionimit objekti kishte nisur edhe të shkatërrohej. Por, pas rinovimit të tij, që përfshin edhe zgjerimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme të objektit, kjo ndërtesë do të shërbejë për nevojat e organizatës "Handikos" në Podujevë.
Kryetari Bulliqi i falënderoi përfaqësuesit e kompanisë "Berisha Group", duke thënë se implementimi i kësaj marrëveshje do të sjellë ndryshime të rëndësishme dhe do të kontribuojë në përmirësimin e jetesës dhe avancimin e qëllimeve për anëtarët e "Handikos" në Podujevë.



# Veprimtari Bislimi takohet me shefin e shëndetësisë dhe të transportit të Gjenevës, bisedojnë për raportet Kosovë - Zvicër

**Prishtinë, 10 korrik** - Sali Bislimi, drejtor i zyrës ligjore "First-consulting.ch" në Bern të Zvicrës dhe drejtor i "Zëri Perëndimor i Kosovës", është mirëpritur në takim nga shefi i Departamentit të Shëndetësisë dhe Transportit në kantonin e Gjenevës, Pierre Maudet, me të cilin ka biseduar për çështjet që kanë të bëjnë me dy shtetet dhe komunitetin shqiptar që jeton në shtetin helvetik.
Ai ka thënë se Maudet i ka shprehur falënderime për shqiptarët që e kanë votuar në zgjedhjet e fundit dhe për gazetën "Epoka e re" e cila i ka dhënë mbështetje.
"Kisha nderin dhe kënaqësinë të mirëpritem ngrohtësisht nga këshilltari i Shtetit, shef i Departamentit të Shëndetësisë dhe Transportit në kantonin e Gjenevës, miku im z. Pierre Maudet. I shoqëruar sot me mikun tim Pierre Yves Grivel vizituam mikun tonë të përbashkët, ku drekuam së bashku dhe biseduam për të gjitha çështjet që lidhen në mes të Kosovës dhe Zvicrës dhe komunitetin tonë këtu. Shprehi një falënderim për të gjithë shqiptarët që votuan për të dhe një falënderim të veçantë gazetën kombëtare 'Epoka e re' qe e kishim në mbështetje për t'i kaluar mesazhet për të mirën dhe mbështetjen e miqve tanë. Përafrimet realiste gjithmonë janë konstruktive", ka shkruar Bislimi në "Facebook".



## Komuna e Malishevës dhe Unioni Shqiptaro-Gjerman nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

Malishevë, 10 korrik - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka pritur në një takim pune përfaqësuesit e Unionit Shqiptaro-Gjerman e V. në Gjermani. Delegacioni i Unionit përbëhej nga Nuhi Krasniqi, kryetar i degës në Kosovë Nuredin Imeraj dhe koordinatori për Malishevë, Nysret Kryeziu.



Gjatë këtij takimi u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi në mes të komunës së Malishevës dhe Unionit Shqiptaro-Gjerman. Qëllimi i këtij memorandumi është forcimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit mes dy palëve si dhe angazhimi i përbashkët për realizimin e projekteve zhvillimore në Malishevë.
Ky memorandum pritet të sjellë përfitime të konsiderueshme për komunën, duke mundësuar implementimin e projekteve të reja dhe zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në vendet e tjera në Gjermani, përfshi edhe diasporën dhe krijimin e kontakteve të reja, përmes të cilave synohet edhe gjetja e investitorëve dhe për shkëmbim të përvojave reciproke në fusha të ndryshme.

## Vitia në mbledhjen e Bordit të ShSKUK-së: Do të punohet për ngritje të cilësisë së shërbimeve shëndetësore

**Prishtinë, 10 korrik** - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka marrë pjesë në hapje të mbledhjes së 53-të të Bordit Drejtues të ShSKUK-së. Fillimisht, ai ka falënderuar kryesuesin e kaluar të Bordit Drejtues, Naim Bardiqit dhe anëtarin Besim Demolli, për punën që kanë bërë deri tani në Bord. Po ashtu, ai tha se kryesuesi i ri Bordit Drejtues, Dren Boshnjaku dhe anëtarët e Bordit do të kenë përkrahjen e plotë nga ministri dhe Ministria e Shëndetësisë.
Ai tha se në bashkëpunim me Bordin do të punohet për ngritje të cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përfshirë edhe shërbimet që ofrohen në klinikat e QKUK-së, spitalet e përgjithshme, por edhe krejt njësitë e ShSKUK-së, për të cilin është punuar edhe në Bord.




Kryesuesi i Bordit Drejtues, Dren Boshnjaku, falënderoi ministrin Vitia për përkrahje dhe bashkëpunim.
Gjatë mbledhjes së Bordit Drejtues raportoi drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-së për punën dhe aktivitetet e zhvilluara.
Bordi ka diskutuar edhe për Raportin e Auditimit të bërë për Spitalin e Përgjithshëm në Vushtrri, në cilin janë dhënë edhe vërejtjet, rekomandimet dhe sugjerimet. Po ashtu, është diskutuar për kërkesat buxhetore 2025.
Anëtarët e Bordit Drejtues miratuan edhe Rregulloren e re për Përdorimin dhe Mirëmbajtjen e Automjeteve në ShSKUK.
Pas mbledhjes, anëtarët e Bordit Drejtues vizituan hapësirat e rinovuara në Klinikën e Onkologjisë dhe atë të Gjinekologjisë me Obstetrikë.

## Përurohet rrjeti i ujësjellësit për fshatrat Zabel i Ulët, Korroticë e Poshtme, Poklek dhe një pjesë e Komoranit

**Drenas, 10 korrik** - Të mërkurën është bërë përurimi i rrjetit të ujësjellësit për furnizim me ujë të pijshëm për fshatrat Zabel i Ulët, Korroticë e Poshtme, Poklek dhe një pjesë e Komoranit.
Përmes këtij projekti janë bërë rreth 800 kyçje shtëpiake.
Drejtori për Infrastrukturë Lokale, Endrit Gllareva, ka bërë me dije se punimet në rrjetin e ujësjellësit janë duke vazhduar edhe në fshatrat e tjera.
Në pranim-dorëzimin e projektit ishin edhe zyrtarët e kompanisë regjionale të Ujësjellësit dhe zyrtarë komunalë.



## KFOR-i trajnon ushtarët për skenarët e kontrollit të turmave dhe trazirave

Prishtinë, 10 korrik - Komanda Rajonale në Perëndim e misionit të NATO-s, KFOR, zhvilloi një stërvitje të quajtur "Swift Rescue", mbajtur në çdo komunë në Kosovën perëndimore, për ta ruajtur gatishmërinë e lartë operacionale. Gjatë stërvitjes, KFOR-i ka njoftuar se ata u trajnuan për skenarët e kontrollit të turmës dhe trazirave dhe testuan disa procedura evakuimi. "KFOR-i vazhdon të zbatojë mandatin e tij - bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të vitit 1999 - për të ofruar një mjedis të sigurt dhe të sigurt për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë dhe lirinë e lëvizjes, në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme. KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit (EULEX), përkatësisht, me të cilët punojmë në koordinim të ngushtë", është bërë me dije në njoftimin për medie të KFOR-it.



# Përurohen renovimet në Klinikën e Urologjisë, investime 1.2 milion euro

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 10 korrik - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia, të shoqëruar nga deputetët Haxhi Avdyli dhe Fitore Pacolli, vizituan Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, përkatësisht Klinikën e Urologjisë, me rastin e përurimit të renovimeve në këtë klinikë.

Gjatë vizitës kryeministri Kurti pati mundësinë t'i shohë nga afër hapësirat e transformuara në këtë klinikë. Ai ka thënë se renovimet të cilat kapin vlerën prej 1.2 milion eurosh janë investime që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve për pacientët, në të njëjtën kohë lehtësojnë punën e palodhshme që bëhet nga ana e stafit shëndetësor të cilët e japin përkushtimin e tyre maksimal. "Tash secila dhomë e ka klimatizimin qendror, ka furnizimin me oksigjen dhe ka të instaluar sistemin për ta thirrur në çdo kohë infermieren prej shtratit ku ndodhet pacienti. Klinika e rinovuar, po ashtu, ka nyje sanitare me kushte dhe standarde moderne dhe një banjë për persona me aftësi të kufizuara, si dhe dyer të zgjeruara për pacientë sipas standardit për shtretër të pacientëve - në të kaluarën, meqë dyert kishin përmasa më të vogla se shtretërit e pacientëve, ishte e nevojshme që pacientët të zhvendoseshin me çarçafë deri në shtratin e tyre", ka thënë Kurti.



Duke falënderuar dhe shprehur mirënjohjen e thellë për të gjithë doktorët dhe infermierët për punën e palodhshme e të pakursyer që bëjnë, kryeministri tha se si qeveri e kanë për obligim t'u krijojnë kushte personelit shëndetësor dhe pacientëve që marrin trajtim.

Në lidhje me këto investime foli edhe ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, i cili tha se ky renovim sot vjen pas takimit që ka pasur me stafin e Klinikës së Urologjisë, e të cilët e kishin njoftuar se Klinika e Urologjisë në bllokun operativ, është klinika me kushtet më të këqija, në të cilën nuk ishte investuar për gati 20 vjet. Ai falënderoi të gjithë profesionistët shëndetësorë, pa dallim në këtë klinikë, mjekë, specialistë e infermierë, duke theksuar se ky rezultat sot është meritë e kërkesave dhe punës së tyre, dhe paralajmëroi se javën tjetër do të hapen edhe sallat operative të Urologjisë dhe në këtë mënyrë Klinika e Urologjisë, nga klinika më problematike në aspektin infrastrukturor në bllokun operativ, po bëhet klinika model në QKUK.

Në Klinikën e Urologjisë kryeministri Kurti u mirëprit nga drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi, drejtori i Urologjisë, Petrit Nura, si dhe personeli shëndetësor.

Rikujtojmë se muajin e kaluar është bërë përurimi i investimeve prej rreth 5.5 milionë eurosh në Klinikën e Gjinekologjisë në QKUK.

# Haradinaj takon Jasharajn, i premton rritje të pagave 50 % për punëtorët e arsimit

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 10 korrik - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur në takim kryetarin e SBAShK-ut, Rrahman Jasharaj, me të cilin ka diskutuar për aktualitetin në arsim. Ai ka thënë se partia që drejton ka respektuar gjithmonë misionin e sindikalistëve në mbrojtjen e interesave të mësimdhënësve.

Haradinaj ka treguar se në këtë takim ka konfirmuar synimin e AAK-së për rritjen e pagave për punëtorët e arsimit në të gjitha nivelet për 50 % si dhe ngritjen e buxhetit për arsim për 6 %. "Unë personalisht dhe Aleanca kemi respektuar gjithmonë misionin e



sindikalistëve në mbrojtjen e interesave të mësimdhënësve. Kemi pasur shumë herë mospajtime, por gjithmonë kemi qenë konstruktivë në veprime që mësimdhënësit të jenë të vlerësuar dinjitetshëm. Në takim me delegacionin e SBAShK-ut, kryesuar nga z. Rrahman Jasharaj, u njoftova për sfidat me të cilat përballen mësimdhënësit dhe arsimi në përgjithësi. Po ashtu, me ta i ndava 14 prioritetet në sferën e arsimit që do të përfshihen në programin zgjedhor të AAK-së 2025-2029. E konfirmova synimin tonë për rritjen e pagave për punëtorët e arsimit në të gjitha nivelet për 50 % si dhe ngritjen e buxhetit për arsim për 6 %. Arsimi do të jetë prioritet i Aleancës!", ka bërë me dije Haradinaj.

## Miratohet vendimi për shpronësimin e pronave për ndërtimin e kompleksit memorial "Masakra e Reçakut"

Prishtinë, 10 korrik - Qeveria e Kosovës ka miratuar propozim-vendimin preliminar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të cilat preken nga realizimi i projektit: konservimi, restaurimi dhe ndërtimi i kompleksit memorial "Masakra e Reçakut".

Ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu, tha se në komunën e Shtimes, Departamenti i Shpronësimit ka mbajtur në muajin qershor një dëgjim publik me pronarët e pronave. "Pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit më 18.06.2024 ka mbajtur dëgjimin publik në komunën e Shtimes me pronarët e pronave dhe ka trajtuar gjatë dëgjimit të gjitha kërkesat e pronarëve. Departamenti i Shpronësimit i propozon Qeverisë së Kosovës të nxjerrë vendim që të miratohet vendimi preliminar për ligjshmërinë e procesit të shpronësimit për interes publik të pronës së paluajtshme e cila preket nga realizimi i projektit", ka thënë Aliu.



## Riparohet dhe rikthehet në operim ekskavatori i KEK-ut

**Prishtinë, 10 korrik** - Punëtorët dhe stafi menaxhues i Divizionit të Prodhimit të Qymyrit (DPQ) në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK sh.a.) kanë arritur me sukses të riparojnë dhe rikthejnë në operim ekskavatorin E-10B. Sipas njoftimit, më 12.06.2024, si pasojë e dëmtimit të mekanizmit të pajisjeve për ulje dhe ngritje të krahut 1, operatorët e ekskavatorit E-10B janë obliguar ta ndalnin me qëllim të evitimit të ndonjë dëmtimi të përmasave më të mëdha. "Falë angazhimit të jashtëzakonshëm të punonjësve dhe menaxhmentit të DPQ-së, janë identifikuar defektet e paraqitura dhe menjëherë kanë filluar me riparimin e të njëjtave, madje duke përdorur teknika dhe teknologji të pa përdorura më parë, me ç'rast edhe është arritur që në kohë optimale të mënjanohen defektet dhe të aftësohet ekskavatori i cili tashmë është në operim dhe në gjendje stabile", thuhet në njoftim.

Lidhur me këtë, Bekir Gerguri, kryeshef ekzekutiv i KEK sh.a, ka falënderuar të gjithë stafin e DPQ-së për përkushtimin dhe vullnetin e tyre për arritjen e rikthimit në operim të ekskavatorit E-10B me sukses, duke i inkurajuar ata të vazhdojnë edhe në të ardhmen me inovacione të tilla të përdorura si në këtë rast, e të cilat ndikojnë pozitivisht në mbarëvajtjen e operimeve ditore dhe sukseset e korporatës.




# ATK-ja verifikon mallrat pa origjinë

**Prishtinë, 10 korrik** - Administrata Tatimore e Kosovës ua rikujton të gjithë tatimpaguesve se në bazë të Ligjit për Administrimin e Procedurave Tatimore, kërkohet dokumentimi i origjinës së mallit.

Aktivitetet e ATK-së në vazhdimësi do të përqendrohen pikërisht te tatimpaguesit të cilët kanë mallra pa dokumentacion. Secili tatimpagues duhet ta ofrojë dokumentacionin mbështetës, i cili arsyeton prejardhjen e mallit si në vendndodhjen apo vendndodhjet e tatimpaguesit, ashtu edhe për mallrat në qarkullim jashtë vendndodhjes së tatimpaguesit.

Po ashtu, secili tatimpagues duhet t'i dokumentojë të gjitha mallrat nga koha e pranimit (qoftë përmes importimit, blerjes, shkëmbimit apo mënyrave të tjera) derisa ato të jenë shitur apo ndryshe të jenë sistemuar, përfshirë dokumentacionin e shitjes apo sistemim tjetër.

Administrata Tatimore e Kosovës inkurajon të gjithë tatimpaguesit t'u përgjigjen në mënyrë të saktë detyrimeve tatimore, në të kundërtën ATK-ja do të detyrohet t'i ndërmarrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor. "Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore ju do të kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare, siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenie shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore", ka njoftuar ATK-ja.



# "Për bukën e motmotit", Kurti nga Malisheva: Prodhimtaria e grurit në Kosovë do t'i tejkalojë nevojat për import



**Malishevë, 10 korrik** - Kryeministri Albin Kurti, bashkë me ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci dhe zëvendësministrin Imri Demelezi, panë nga afër korrje-shirjen e grurit të fermerit Asman Kryeziu në Bubavec të Malishevës. Teksa vlerësoi punën e fermerit, përmes të cilit djerrinat me gurë janë bërë tashmë ara me grurë, kryeministri theksoi se kjo është edhe në funksion të programit të qeverisë që bukën e motmotit ta kemi tonën, pra buka jonë, në sofrën tonë, nga toka jonë.

Ai theksoi se buxheti për Ministrinë e Bujqësisë është rreth 100 milionë euro, mbështetje e cila mundëson subvencionime e lehtësira për fermerët tanë. "Buxheti për Ministrinë e Bujqësisë është rreth 100 milionë euro, siç edhe kemi premtuar, dhe tash në njërën anë subvencionojmë edhe naftën, edhe plehun, edhe rendimentin me katër cent, këtë të fundit për kilogram, e në anën tjetër edhe i kemi zvogëluar jashtëzakonisht shumë dokumentet që i nevojiten bujkut tonë për të aplikuar për subvencione", u shpreh kryeministri Kurti.

Në përfundim, kryeministri Kurti tha se me prodhimtarinë e shtuar prej 140 mijë deri në 150 mijë tonë grurë, do ta mbulojmë e tejkalojmë importin që e kemi pasur prej 139 mijë tonë grurë në vitin e kaluar, si dhe ritheksoi përkushtimin e qeverisë për mbështetjen e bujqve anembanë Kosovës.

## MFPT filloi shpërndarjen e tabletëve për punonjësit e qendrave për punë sociale

**Prishtinë, 10 korrik** - Në kuadër të procesit të digjitalizimit të shërbimeve, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve filloi të mërkurën shpërndarjen e tabletëve për punonjësit e qendrave për punë sociale në rajonin e Prishtinës.

Shpërndarja e tabletëve ka për qëllim garantimin e efikasitetit të zbatimit të projektit të pilotimit të asistencës sociale. Në takim ishin të pranishëm më shumë se 50 punonjës të QPS-ve, të cilët u informuan lidhur me zbatimin e projektit të pilotimit të asistencës sociale. Shpërndarja e tabletëve do të vazhdojë edhe në ditët në vijim me punonjësit e QPS-ve në rajonet e tjera të Kosovës.



# Lojërat e Orbanit kanë tronditur Brukselin



Hungaria mori më 1 korrik 2024 presidencën e Këshillit Europian, që do ta mbajë për gjashtë muaj me radhë dhe kryeministri Viktor Orban para se të shkonte në Uashington qëndroi për vizita në Kiev, Moskë e më pas në Pekin, duke luajtur rolin e një lloj ndërmjetësuesi të vetëemëruar dhe stimuluesi të vetëshpallur të paqes.
Përmes një videoje të publikuar në "X" ditën e hënë, Orbani e vlerëson Kinën si fuqinë e vetme botërore "të angazhuar dukshëm për vendosjen e paqes" midis Rusisë dhe Ukrainës dhe kur tregon për takimin e tij me presidentin kinez, Xi Jinping, e portretizon veten si dikë që është në mision paqeje.
BE e kritikoi ashpër Orbanin pas takimit që bëri me presidentin rus Vladimir Putin, duke theksuar se ai "nuk është duke përfaqësuar BE në asnjë lloj mënyre."
Zëvendëskancelari gjerman Robert Habeck tha se takimet e Orbanit duhen parë si çështje bilaterale dhe jo në kuadër të ndonjë angazhimi zyrtar për BE.
Sidoqoftë Orbani është duke dëshmuar edhe një herë se është enfant terrible në bllokun e 27 vendeve anëtare. Ekspertët thonë se përpjekjet e fundit të Orbanit janë pjesë e një plani afatgjatë për ta paraqitur veten si udhëheqës të së djathtës ekstreme të Europës, dhe se mbështet kandidatin republikan për president amerikan, Donald Trumpin, që të kthehet në pushtet.

## Cilat janë synimet politike të Orbanit?

Nuk ka asgjë të re në mbështetjen e kryeministrit hungarez Orban për Rusinë ose koketërinë me Kinën. Dy vitet e fundit ai ka kundërshtuar vazhdimisht sanksionet e BE kundër Moskës dhe është munduar të bllokojë ndihmat për Ukrainën.
Dhe në një kohë kur BE është duke u përpjekur të zgjerojë tregtinë jo me Kinën por me vendet e tjera, dhe të ulë rrezikshmërinë e zinxhirëve kritikë të furnizimeve me lëndë të para, Budapesti ka përqafuar tregtinë me Pekinin, duke filluar këtë maj një partneritet strategjik gjithëpërfshirës.
Julien Hoez, këshilltar politik dhe ekspert në çështjet e BE-së, thotë se lojërat e fundit të Orbanit synojnë të rrisin mbështetjen që Hungaria i jep, pasi partia e tij Fidesz mori në zgjedhjet europiane mbajtur muajin e kaluar rezultatin më të keq zgjedhor të marrë ndonjëherë.
Megjithëse partia e Orbanit dhe aleatët e saj morën 44 përqind të votave, ata humbën votat që shkuan për Peter Magyarin, një njeri që ka qenë i afërt me Orbanin, por që është kthyer në rival të fortë dhe shihet si kërcënim serioz.
Por kjo është vetëm një nga dëshirat që Orbani mbart me vete. Ai do po ashtu ta prezantojë veten si udhëheqës të së djathtës ekstreme të Europës, e cila është duke u zgjeruar dhe të krijojë kështu një "aks joliberal" nga SHBA në Europë, thotë Hoez.
"Ai është duke u përpjekur ta prezantojë veten si udhëheqës të europianëve që janë skeptikë ndaj Europës, që janë më shumë të interesuar për të pasur marrëdhënie me Kinën ose Rusinë ose që nuk duan fare të përzihen me të tjerët dhe në përgjithësi tregojnë tendenca izolacioniste të të gjitha llojeve si ato që shihen në SHBA."

## Lojërat e Orbanit kanë tronditur Brukselin

Në takimin e radhës të përfaqësuesve të përhershëm të vendeve anëtare të BE-së, ata me siguri që do të diskutojnë rolin që duhet të luajë presidenca e radhës dhe nëse Hungaria mund të jetë një ndërmjetësues i besueshëm.
Ekspertët thonë se BE nuk ka çfarë të bëjë tjetër për ta dënuar Orbanin. Një opsion bërthamor që do të kufizonte të drejtat e Hungarisë në bazë të Ligjit 7 të Marrëveshjes së Bashkimit Europian është duke u pëshpëritur shpesh, por nuk mendohet se do të përdoret kësaj here.
Ndërkohë në përgjigje të postimit të lartpërmendur Orbanit në X, i biri i Trumpit, Donald Trump junior, e vlerësoi udhëheqësin hungarez si nxitës të paqes „siç është im atë".
Hapin tjetër Orbani e hedh në Uashington. Tani po hamendësohet nëse ai do të takohet me Trumpin gjatë qëndrimit në SHBA, apo thjesht do të marrë pjesë në samitin e NATO-s për nder të 75-vjetorit të krijimit të aleancës.

DW




# Sport

EURO2024 GERMANY


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Kastrioti nis në raundin e parë, Rahoveci e Besa në të dytin



**Ferizaj, 10 korrik** - Kastrioti i Ferizajt fillon garimin në raundin e parë të Kupës Evropiane për hendbollistë. Shorti për raundin e parë tërhiqet më 16 korrik, ndërsa ndeshjet luhen më 14/15 dhe 21/22 shtator. Në short, fituesi i Kupës së Kosovës, Kastrioti, do të jetë bartës. Gjithsej 20 skuadra nisin garimin në raundin e parë të EHF European Cup. Ndërkohë prej raundit të dytë garimin në Kupën Evropiane e nisin kampioni Rahoveci dhe nënkampionia Besa Famgas. Edhe për raundin e dytë shorti është më 16 korrik, kurse ndeshjet zhvillohet më 19/20 dhe 26/27 tetor. Në short, Rahoveci është bartës, ndërsa Besa Famgas jo. Plot 63 skuadra janë paraqitur për të garuar në Kupën Evropiane.

# Anglia fiton ndaj Holandës, i bashkohet në finale Spanjës

**Dortmund, 10 korrik** - Anglia ka kaluar në finale të "Euro 2024", aty ku do të përballet me Spanjën më 14 korrik, pasi eliminoi Holandën me rezultat 2-1 në gjysmëfinale. Ndeshja fillimisht nisi me kujdes të shtuar nga të dyja ekipet, por që ritmi i lojës filloi të rritej. Ishte minuta e shtatë kur Xavi Simons lëshoi një super goditje, për të mposhtur Jordan Pickfordin për 1-0. Por, "Tre Luanët" fituan një penallti të dyshimtë, nga një ndërhyje e Denzel Dumfries në Harry Kane. Gjyqtari fillimisht tha se nuk ka penallti, por nga rishikimi në VAR, arbitri vendosi të jepte goditje nga pika e bardhë, e cila u realizua nga Kane në minutën e 18-të. Anglia më pas mori lojën nën kontroll, duke rrezikuar Holandën që dukej e humbur pas golit të pësuar. Ishte minuta e 23-të kur Phil Foden mposhti edhe portierin e Tulipanëve kur futi topin mes këmbeve, por Dumfries largoi topin nga vija e portës. Shtatë minuta më vonë, Dumfries lëshoi një gjuajtje me kokë, por Anglia ishte me fat, pasi topi u ndal në shtyllë. Dy minuta më vonë, Foden testoi sërish portierin e Holandës, ndërsa këtë here u ndal nga shtylla e majtë. Pjesa e dytë ishte shumë e varfër për nga ritmi i lojës, pasi të dyja kombëtaret nuk treguan shumë, por që zëvendësuesi Ollie Watkins bëri diferencën. Rasti i parë serioz në këtë pjesë erdhi në minutën e 65-të, kur Vigil Van Dijk gjuajti me kokë, por që Jordan Pickford bëri një pritje bravuroze. Në minutën e 79-të, Bukyo Saka mendoi se kishte shënuar gol, mirëpo asistuesi Kyle Walker ishte në pozicion jashtë loje dhe VAR-i e anuloi. Ollie Watkins ishte heroi i Tre Luanëve, që realizoi për 2-1 në minutën e 90+1-të me një asistim të Ciole Palmer. Anglia do të përballet me Spanjën të dielën e këtaj jave (14 korrik), për të përcaktuar se ku do të shkojë trofeu i "Euro 2024".



# Peja pjesëmarrëse në kualifikimet për FIBA Europe Cup



